

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme me të cilën kryesonte Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 29.04.2024, duke shqyrtuar mbi Iniciativën e paraqitur nga avokati Dragan Tonevski nga Shkupi, Su-03.nr.541/22 të datës 05.09.2023, në bazë të nenit 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 96/19), miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK PARIMOR

Agjencia për punësime të përkohshme (Agjencia private për punësim) ka të drejtën e kompensimit të dëmit nga punëdhënësi – shfrytëzues, për kompensimin nga marrëdhënia e punës që ia ka paguar punëtorit të përkohshëm të agjencisë.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është paraqitur Iniciativë nga avokati Dragan Tonevski nga Shkupi, në përputhje me nenin 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat (“G. Zyrtare e RM” nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe G. Zyrtare e RMV” nr.96/19), për miratimin e qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor me rëndësi për sigurimin e barazisë nga gjykatat, për shkak të ekzistimit të praktikës së ndryshme gjyqësore sa i përket zbatimit të nenit 3-a paragrafi (7) dhe nenit 3-b paragrafi (1) të Ligjit për Agjenci private për punësim (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.49/06....27/16). Sipas paraqitësit për zbatimin e barabartë të ligjeve, nevojitet që Seanca e përgjithshme të deklarohet sa i përket çështjes juridike në vijim: “A ka të drejtë për kompensimin e dëmit Agjencia për punësime të përkohshme (Agjencia private për punësim) nga punëdhënësi – shfrytëzues, për kompensimin nga marrëdhënia e punës që ia ka paguar punëtorit të përkohshëm të Agjencisë?”

Iniciativës i janë bashkëlidhur disa vendime gjyqësore, nga analiza e të cilës rezulton se ka praktikë të ndryshme gjyqësore sa i përket çështjes së theksuar juridike edhe atë në kuadër të rajonit të njëjtë të apelit, si dhe të dy rajoneve të ndryshme të apelit, dhe duhet që në përputhje me nenin 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe neni 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat dhe neni 63 nga Rregullorja e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14/22), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë mendim juridik parimor për sigurimin e barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Në përputhje me nenin 3-a paragrafi (7) të Ligjit për agjencitë për punësime të përkohshme (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 49/06, 102/08, 145/10, 136/11, 13/13, 38/14, 98/15, 147/15, 27/16, 119/16 dhe 21/18), kushtet themelore për punë dhe punësim paraqesin kushtet e punës dhe punësim të përcaktuara me ligjet dhe me rregullat tjera, me

marrëveshje kolektive dhe akte të punëdhënësit-shfrytëzues, të cilët i referohen kohëzgjatjes së orarit të punës, punës jashtë orarit, pauzave, periudhave të pushimit, punës së natës, festave dhe kompensimeve.

Në nenin 3-b paragrafi (1) nga i njëjti ligj është përcaktuar se kushtet themelore për punë dhe punësim të punëtorëve të përkohshëm të agjencive që do të përmbushen gjatë kohës së kalimit të tyre te i njëjti punëdhënësi-shfrytëzues, janë ato të njëjtat kushte që do të siguroheshin nëse punëtorët do të ishin të punësuar direkt nga i njëjti punëdhënësi për realizimin e të njëjtës punë.

Në përputhje me nenin 11 paragrafi (3) nënpika 11 të Ligjit për agjencitë për punësime të përkohshme ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.49/06...27/16), marrëveshja e kalimit nga paragrafi (1) i këtij neni, përfshin sidomos detyrimet e shfrytëzuesit për pagimin e shtesave dhe kompensimeve, në përputhje me ligj dhe me marrëveshjen kolektive.

Me ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për agjencitë private për punësim ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.113 të datës 20.06.2018) ndërpritet të vlejë Ligji për agjencitë për punësimet e përkohshme ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.49/06, 102/08, 145/10, 136/11, 13/13, 38/14, 98/15, 147/15, 27/16, 119/16 dhe 21/18).

Me dispozitat e cituara ligjore janë rregulluar kushtet themelore për punësimet e përkohshme, e ato janë të njëjtat kushte që do të siguroheshin nëse punëtorët do të punësoheshin direkt nga i njëjti punëdhënësi për realizimin e të njëjtës punë, dhe sidomos detyrimet e shfrytëzuesit për pagesën e shtesave dhe kompensimeve në përputhje me ligj dhe me marrëveshjen kolektive.

Në fakt, me dispozitat e theksuara punëtorët e përkohshëm të agjencive i kanë të njëjtat të drejta, të cilat te punëdhënësi – shfrytëzues i kanë punëtorët e tyre, të cilët direkt kanë lidhur marrëdhënie të rregullt pune me punëdhënësin – shfrytëzues, dhe në kushte kur punëdhënësi – shfrytëzues ka pasur detyrim ligjor që punëtorëve të tij të rregullt t'ju paguajë ndonjë kompensim, detyrim të tillë të njëjtë ka pasur edhe ndaj punëtorëve të përkohshëm që i janë kaluar nga Agjencia për punësime të përkohshme. Nga dispozitat e nenit 3-a paragrafi (7), neni 3-b paragrafi (1) dhe neni 11 paragrafi (3) nënpika 11 të Ligjit për agjenci për punësime të përkohshme rezulton se kushtet themelore për punë dhe për punësim paraqesin kushtet për punë dhe punësim të përcaktuara me ligjet dhe rregullat tjera, marrëveshjet kolektive dhe aktet e punëdhënësit – shfrytëzues, ndërsa ato janë të njëjtat kushte që do të siguroheshin nëse punëtorët do të ishin të punësuar direkt nga i njëjti punëdhënësi për realizimin e të njëjtës punë, ndërsa në anën tjetër marrëveshja e kalimit përfshin se cilat janë detyrimet e shfrytëzuesit për pagimin e shtesave dhe kompensimeve në përputhje me ligj dhe me marrëveshjen kolektive.

Sa i përket kësaj çështje juridike për të drejtën e regresit të Agjencisë për punësime të përkohshme ndaj punëdhënësit – shfrytëzues, për kompensimin e paguar të punëtorit të përkohshëm, ka procedim të ndryshëm të gjykatave dhe atë një pjesë e gjykatave kanë marrë vendime me të cilat janë aprovuar kërkesëpaditë e Agjencisë për punësime të përkohshme ndaj punëdhënësit – shfrytëzues që duhet t'i paguajë si regres kompensimin e paguar, në mënyrë që duke u referuar në dispozitat e zbatimit të nenit 3-a paragrafi (7) dhe nenit 3-b paragrafi (1) dhe neni 11 të Ligjit për agjenci për punësime të përkohshme, për arsye që punëtorit të përkohshëm nga agjencia i takojnë të drejtat e njëjta nga marrëdhënia e punës sikur të ishte i punësuar direkt te punëdhënësi – shfrytëzues. Në anën tjetër gjykatat e rajonit të apelit Shtip në disa vendime e kanë refuzuar kërkesëpadinë e Agjencisë për punësime të përkohshme ndaj punëdhënësit – shfrytëzues

për regres ngase kanë ardhur në përfundim se Agjencia për punësime të përkohshme si punëdhënëse është e detyruar ti paguajë punëtorit të përkohshëm nga agjencia të gjitha detyrimet që rezultojnë nga marrëdhënia e punës dhe se në përputhje me marrëveshjen për kalim të punëtorëve për realizimin e punëve të përkohshme të lidhura me palët, ku palët e kontraktuara i kanë vërejtur të drejtat dhe detyrimet e tyre, të njëjtët nuk kanë vërejtur se i padituri si punëdhënës – shfrytëzues është i detyruar që punëtorit përkohësisht të kaluar t’ia sigurojë të drejtën e kompensimit.

Nga këtu, gjatë ekzistimit të dispozitave ligjore për mënyrën e rregullimit të punësimit të përkohshëm, rezulton se në këtë rast në përputhje me nenin 3-a dhe nenin 3-b dhe nenin 11 paragrafi (3) nënpika 11 të Ligjit për agjenci për punësime të përkohshme, janë rregulluar kushtet themelore për punësime të përkohshme dhe se ato janë të njëjtat kushte që do të siguroheshin nëse punëtorët do të ishin të punësuar direkt nga i njëjti punëdhënës për realizimin e të njëjtës punë, dhe në këtë rast kur Agjencia për punësime të përkohshme i ka paguar punëtorët e përkohshëm nga agjencia një kompensim të caktuar nga marrëdhënia e punës, punëdhënësi – shfrytëzues duhet ti paguajë regres për kompensimin e paguar.

Seanca e përgjithshme
e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut